RAPORTI VJETOR

2019

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Shkurt, 2020

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 3
BAZA LIGJORE 4
I. Baza ligjore ekzistuese 4
II. Vështirësitë ligjore që i ka hasur Organi Shqyrtues i Prokurimit në përmbushjen e misionit të tij 4
III. Përmisimi i bazës ligjore 5
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT 5
I. Misioni/Vizioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit 5
II. Faqja e Internetit 7
III. Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik 8
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL 10
I. Organizimi, veprimtaria, personi dhe niveli i rrogave 10
II. Bordi 11
III. Sekretariati 11
IV. Burimet Njerëzore 12
a) Numri i punëtorëve 12
b) Nevojat për punëtorët të rinjë 12
c) Numri i trajnimeve dhe nevojat për tajnim 13
V. Puna gjatë vitit 2019 13
GJOBAT DHE ANKESAT 20
I. Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik 21
II. Urdhëresat e Shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese 22
III. Diskualifikimi i Operatorëve Ekonomikë 23
IV. Të Dhënat nga Gjykatat 25
TË GJETURAT E ZYRËS SË PËRGJITHSHME TË AUDITORIT 26
SHTOJCA I - RAPORTI FINANCIAR 2019 27

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2019 ka inicuar ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës së Punës, e cila tanimë përbën draft të finalizuar, dhe e njëjta është e publikuar në uebfaqe të Organit Shqyrtues të Prokurimit për komente eventuale.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2019 ishte ballafaquar me probleme në anëtarësinë e plotë të bordit, i cili njëherit luan rolin e panelit shqyrtues për shqyrtimin e ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomikë lidhur me aktivitetet e tenderimit.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2019 ka bërë arritjen e njërit prej synimeve strategjike të saj, konkretisht përmisimin e transparencës në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Kjo ishte arritur përmes lansimit të uebfaqes së re zyrtare, ku ndër të tjerash, në uebfaqe transmetohen drejtëpërsëdrejti seancat dëgjimore të mbajtuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

- Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2019 ka hartuar për herë të parë Strategjinë e Komunikimit. Kjo strategji shërben për ofrimin e informacionit me kohë dhe promovimin e shqyrtimit efektiv të ankesave në lidhje me prokurimin publik në Kosovë.

- Gjatë vitit 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit gjithsej i ka shqyrtuar 981 ankesa të parashtruar nga operatorët ekonomikë kundrejt vendimeve të autoriteteve kontraktuese lidhur me aktivtetet tenderuese.

BAZA LIGJORE

I. Baza ligjore ekzistuese

1. Organi Shqyrtues i Prokurimit veprimtarinë e ushtron konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimit e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, Rregulloren Nr. 01/2017 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe legjislacionin dytësor të prokurimit publik të hartuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.

II. Vështirësitë ligjore që i ka hasur Organi Shqyrtues i Prokurimit në përmbushjen e misionit të tij

2. Mungesa e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit ka shkaktuar mbingarkesë në punën e OSHP-së, por duke pasur parasysh numrin e ankesave të pranuara dhe atyre të përfunduara deri në fund të vitit, mund të themi se situata po menaxhohet mirë nga anëtaret aktual të Bordit të OSHP-së.

3. Organi Shqyrtues i Prokurimit, ndër vite ka potencuar numrin e vogël të stafit të brendëshem, veçanërisht të ekspertëve shqyrtues, duke u detyruar kështu që të angazhojë një numër të madh të ekspertëve të jashtëm për të shqyrtuar ankesat e pranuara, e që në vitin 2019 kanë qenë në rritje. Për këtë arsye, OSHP konsideron se është i domosdoshem që buxheti i caktuar për OSHP-në si organizatë buxhetore të rritet në mënyrë që plotësohen nevojat për angazhim të ekspertëve të jashtem shqyrtues profesional e teknik, të rritet numri i trajnimëve të stafit aktual dhe atyre që pranohen në punë rishtas, dhe të aprovohen poashtu pozita shtesë në porporcion me numrin e ankesave te pranuara.

III. Përmisimi i bazës ligjore

4. Gjatë vitit 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte inicuar ndryshim/plotësimin e rregullores së brendshme të punës, me ç'rast rekomandimet e z. Steen Bruun-Nielsen, janë evidentuar ku modelet e sygjeruara për akt-ekspertizë dhe vendim të paneleve shqyrtuese, janë përfshirë si akte të brendshme të Oranit Shqyrtues të Prokurimit, të cilat do të përdoren nga viti 2020 e tutje nga ekspertët dhe paneli shqyrtues.

5. Sipas rekomandimëve të ekspertit z. Steen Bruun-Nielsen, OSHP duhet të zhvilloj takime të rregullta në mes të Ekspertëve Shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues në mënyrë që të diskutohen vendimet dhe nevojat për ndryshime në praktikën e Organit Shqyrtues të Prokurimit; (2) të bëj përmisimi e databazës së Organit Shqyrtues të Prokurimit në mënyrë që të lehtësohet hulumtimi mbi praktikën juridike të Organit Shqyrtues të Prokurimit; (3) të hartoj një model të akt-ekspertizës që do të mundësonte që të hartohet një ekspertizë duke i adresuar pretendimet e palëve, dhe identifikimin e precedentëve të kaluar; (4) të bëj hartimin e një modeli të vendimit të panelit shqyrtues që do të përmirsonte disa aspekte të shqyrtimit lidhur me raste paraprake/precedentë të praktikës juridike të zhvilluar në Organ Shqyrtues të Prokurimit, e që pjesa më e madhe e këtyre rekomandimeve janë përmbushur gjatë vitit 2019.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

I. Misioni/Vizioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit

6. Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Planit Strategjik të OSHP-së për vitet 2018-2020, si vizion primar ka karakterizimin si një instituticion kredibil, efikas dhe efektiv në çështjet e prokurimit publik, si dhe shqyrtimi i ankesave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duke i pasur parasysh praktikat më të mira të

Bashkimit Evropian dhe legjislacionit të tij lidhur me prokurimin publik, dhe ofrimin e mbrojtjes ndaj operatorëve ekonomikë vendorë, dhe të huaj lidhur me shkeljet eventuale të bëra nga autoritetet kontraktuese.

7. Në përputhje me vizionin primar, Organi Shqyrtues i Prokurimit promovon dhe ngritjen e transparencës, mundësimin në qasje në dokumente publikë, dhe rritjen e kapaciteteve profesionale, si dhe bashkëpunimi me akterët relevantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

8. Për të arritur synimet e parapara me aktet e brendeshme të saj, Organi Shqyrtues i Prokurimit, në fund të vitit 2019 ka nisur transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave dëgjimore që mbahen me operatoret ekonimik dhe autoritetet kontraktuese, dhe të gjitha palëve të interesit. Me paraqitjen drejtperdrejtë të seancave dëgjimore në ueb sajt, OSHP po arrin atë që gjithmonë ka pasur qëllim të arrij, transperencën në raport me palët e interesit dhe popullatën në tërësi. Rritja e transparencës ndaj operatoreve ekonomik nëpërmjet avancimit të ueb faqes për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara, është një ndër synimet kyqe për OSHP-në.

9. Me datën 12 dhjetor 2019, OSHP ka lansuar uebfaqen dhe databazën e re të vendimeve. Qëllimi i krijimit të kësaj databaze të re për OSHP-në është rritja e efikasitetit në kërkim të të dhënave rreth vendimeve të OSHP-së për të gjitha palët, duke rritur kështu transparencën dhe efikasitetin e punës së institucionit.

10. Databaza është arritje mjaft e rëndësishme për OSHP-në, pasi lejon ruajtjen e të gjitha dhënave të institucionit në format të lexueshëm digjital. Qëllimi i krijimit të databazës është mundësimi i një baze të të dhënave ku do të futen të gjitha shkresat në formë digjitale në mënyrë që të lehtësohet kërkimi i të dhënave për të gjitha palët që u interesojnë vendimet e OSHP-së në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomik, por edhe vete OSHP-se ne avancimin e konsistencës se vendimeve. Databaza ju lejon palëve të treta që shumë lehtë të gjejnë dhe te krahasojnë vendimet e ngjashme me ankesat e tyre, dhe kështu do te rritë bazën e

informimit jo vetëm për operatorët ekonomik, por për çdo palë tjetër që dëshiron të informohet për mbarëvajtjen e proceseve ankimore në prokurimin publik në Kosovë.

11. Në vitin 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka përcaktuar zhvillimin e komunikimit të institucionit përmes hartimit të Strategjisë së Komunikimit 2020, ku objektivat e komunikimit janë të lidhura ngushtë dhe rrjedhin nga qëllimi i përgjithshëm dhe misioni i OSHP. Ofrimi i informacionit me kohë dhe promovimi i shqyrtimit efektiv të ankesave në lidhje me prokurimin publik në Kosovë, me fokus të veçantë në promovimin e praktikave të BE-së në këtë fushë, është një ndër objektivat kyç të institucionit që synohen të arrihen edhe përmes strategjisë. OSHP, poashtu objektiv të punës ka të jetë në shërbim të operatorëve ekonomikë dhe të mbrojë të drejtat e ligjshme nga veprimet apo mos veprimet e autoriteteve kontraktuese, andaj rritja e transparencës ndaj operatorëve ekonomik nëpërmjet avancimit të ueb faqes për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara synohen të arrihen me strategjinë e komunikimit që është hartuar në fund të vitit 2019.

II. Faqja e Internetit

12. Organi Shqyrtues i Prokurimit, me qëllim të rritjes së transparencës përballë të gjitha palëve të involvuara në aktivitete të prokurimit, dhe transparencës karshi qytetarit të Kosovës, ka uebfaqen zyrtare "https:/oshp.rks-gov.net", ku bën publikimin e pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik, të cilët pretendojnë se ju janë shkelur nga autoritetet kontraktuese, raportet e ekspertizave dhe vendimet e panelit shqyrtues për çdo lëndë. Po ashtu, web- faqja përmban versionet elektronike, të të gjitha vendimeve të Paneleve Shqyrtuese, konkluzioneve, urdhëresave, njoftimeve, ekspertizave, raporteve dhe informatave tjera të rëndësishme lidhur me aktivitetet e OSHP-së.

13. Gjatë vitit 2018, OSHP ka filluar projektin e financuar nga USAID/TEAM për zhvillimin e uebfaqes, databazës si dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave

dëgjimore (live stream), i cili ka përfunduar në dhjetor të vitit 2019. Po ashtu OSHP ka implementuar platformën elektronike të prokurimit (e-Prokurimi).

14. Gjatë vitit 2019, kanë qenë 514,922.000. (pesëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e dy klikime). Prej këtyre klikimeve, 70.7 % kanë qenë vizitorë të rijnë të ueb faqes, kurse 29.3 % janë vizitor të rregullt të ueb faqes së OSHP-së. Kurse kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të një vizitori në ueb faqe të OSHP-së, ka qenë 04:41 min.

15. Ueb faqja e OSHP-së, përveç që është vizituar nga qytetarët e Republikës së Kosovës (14,011.00 vizitorë), po ashtu është vizituar edhe nga vendet e Evropës dhe Amerikës, siç janë: Shqipëria (525 vizitorë), SHBA (602 vizitorë), Serbi (48 vizitorë), Gjermani (546 vizitorë), Maqedonia e Veriut (74 vizitorë), Zvicër (39) etj.

III. Kompetencat e Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik

16. Organi Shqyrtues i Prokurimit disponon një mori kompetencash, të specifikuara në pjesën IX, nenin 105 të ligjit të prokurimit publik nr. 04/L-042, të cilat kompetenca saktësohen si në vijim:

    16.1. Të shqyrtojë ankesat nga palët me interes lidhur me shkeljet e pretenduara nga ligji i prokurimit publik;

    16.2. Të jap urdhëra ndaj çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar që një person, ndërmarrje ose autoritet publik të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente, dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues i konsderon relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;

16.3. Të jap urdhëra ndaj çdo personi për t`u paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të jap dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues e konsideron relevante për vendosje në çështjen e prokurimit;

16.4. Të jap urdhër me të cilën menjanjohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike, nëse kontrata publike nuk është nënshkruar ende nga palët kontraktuese;

16.5. Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta suspendojë ose përfundojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit, ose ta urdhëroj autoritetin kontraktues zbatimin e vendimit të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;

16.6. Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që ta kompensojë parashtruesin e ankesës;

16.7. Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë palë tjetër me interes;

16.8. Ta urdhëroj autoritetin kontraktues që t`i menjanojnë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike dhe/ose financiare të përzgjedhjes, kërkesat dhe/ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit dhe/ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit;

16.9. Të lëshoj urdhëra me të cilin detyrohen zyrtarët të bëjnë zbatimin e një vendimi dhe/ose urdhëri të OSHP-së;

16.10. Të lëshoj urdhëra për ta shëndrruar një kontratë publike të lidhur si jo-efektive, nëse janë plotësuar rrethanat të përcaktuara me ligj të prokurimit publik;

16.11. Të imponoj gjoba ndaj autoritetit kontraktues, nëse ky i fundit vazhdon implementimin e kontratës përkundër faktit se OSHP e ka shpallur kontratën publike pa efekt juridik; dhe

16.12. Kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj të prokurimit publik dhe ligje përkatëse.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

I. Organizimi, veprimtaria, personeli dhe niveli i rrogave

17. Organi Shqyrtues i Prokurimit konform Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, përfaqësohet nga nga Kryetari, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe përgjegjës për administrimin e përditshëm të veprimtarisë së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Për ndonjë fushë specifike, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit mund të delegojë funksionet dhe përgjegjësitë e tij tek ndonjë anëtar tjetër i Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në mungesë të Kryetarit, kompetencat dhe funksionet e Kryetarit ushtrohen nga anëtari më i vjetër i Organit Shqyrtues i Prokurimit.

18. Kryetari i Organit Shqyrtues së Prokurimit njëherit është anëtar i bordit. Bordi mbështetet nga sekretariati, i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit i Organit Shqyrtues të Prokurimit për menaxhimin e punëve ditore.

19. Në kuadër të sekretariatit, konform rregullores të Organit Shqyrtues të Prokurimit, funksionon Divizioni i Brendshëm, Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave, dhe Njësia Ligjore.

II. Bordi

20. Përbërja e anëtarëve të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është pesë (5), mirëpo, prej datës 07 korrik 2017, me anë të vendimit P.Sh. Nr. 494/17 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, konform nenit 101 të Ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092 dy (2) anëtarë të bordit janë suspenduar meqë Kuvendi i Kosovës ka njoftuar Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, iu ishte ngritur aktakuza. Që nga 06 korrik 2017, OSHP punon vetëm me tre anëtar Bordi e që dy ish anëtarëve tani më ju ka skaduar edhe mandati. Në fillim të vitit 2019, Qeveria e Kosovës ka shpallur konkursin për plotësimin e dy vendeve të lira në Bord, por ende nuk ka asnjë informatë zyrtare lidhur më plotësimin e dy vendevë të lira dhe konkursin e shpallur, andaj konsiderojmë se kjo çështje do të adresohet së shpejti tek institucionet gjegjese.

21. Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të bordit është pesë (5) vjeçar. Mandati i Kryetarit dhe dy anëtarëve aktual ju skadon me datë 30 mars 2021.

22. Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është organ vendimarrës sa i përket shqyrtimit të ankesave të parashtruar nga operatorët ekonomikë. Punën e tyre e zhvillojnë përmes paneleve shqyrtuese, ku me ç'rast përmes seancave, qoftë dëgjimore apo të mbyllura, vendosin mbi themelësinë e ankesave të operatorëve ekonomik.

III. Sekretariati

23. Sekretariati udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit, organ i cili është përgjegjës që t`i ofroj mbështetje administrative bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit,

të bëjë menaxhimin e punëve ditore, dhe të zhvilloj politikat e rekrutimit për shërbyes civil dhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm profesional dhe teknikë, varësisht nga nevojat e institucionit.

IV. Burimet Njerëzore

24. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka Zyrën për Burime Njerëzore, si njësi e veçantë në kuadër të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës, dhe politikave të punësimit sa i përket të punësuarve në Organ Shqyrtues të Prokurimit.

a) Numri i punëtorëve

25. Për vitin 2019, Organi Shqyrtues të Prokurimit e ka mbyllur vitin me dy (2) Zyrtarë të Lartë Ligjorë, një (1) Zyrtar për të Hyra, një (1) Zyrtar për Pranimin e Ankesave; një (1) Zyrtar për Teknologji Informative; një (1) Zyrtar për Arkivë; një (1) Zyrtar Kryesor për Financa, një (1) Zyrtar i Lartë Gjuhësore; një (1) Menaxhere e Personelit; gjashtë (6) Ekspert Shqyrtues.

26. Vlen të theksohet se për vitin 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit për herë të parë ka rekretuar dy (2) bursistë të skemës Young Cell Scheme, në kuadër të marrëveshjes së Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me kontratë të punës për një periudhë tre (3) vjeçare. Pozitat e alokuara janë një (1) Zyrtar i Lartë Ligjor, dhe një (1) Ekspert Shqyrtues. Po ashtu, Organi Shqyrtues i Prokurimit në janar të vitit 2020, ka rekrutuar dhe një (1) Zyrtare të Lartë Ligjore në kuadër të marrëveshjes së lartë përmendur.

b) Nevojat për punëtorët të rinjë

27. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka identifikuar nevoja për punëtorë të rinjë e ku si rezultat është duke i zhvilluar procedurat e rekrutimit për një (1) Zyrtar të Lartë

Ligjor, tre (3) Eskpertë Shqyrtues; një (1) Zyrtar i Lartë Ekzekutiv; një (1) Asistent Ekzekutiv për Panelin Shqyrtues; një (1) Përkthyes/e nga gjuha Shqipe në atë Sërbe dhe anasjelltas, dhe një (1) Zyrtar për Teknologji. Procedurat e rekrutimit kanë qenë të monitoruara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese- BIRN.

28. Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka poashtu nevoje per staf shtesë në mënyrë që të zvogëloj angazhimin e eskeprteve të jashtëm, që marrin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të OSHP-së.

c) Numri i trajnimeve dhe nevojat për tajnim

29. Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vitit 2019 ka dërguar në trajnimin "Menaxhimi i pasurive përmes SIMFK dhe E-pasuria" të mbajtur në Durrës, dy (2) ekspert shqyrtues, zyrtarin kryesor financiar dhe asistentin ekzekutiv të OSHP-së. Poashtu, gjatë vitit 2019, i gjithë stafi i OSHP-së, ka ndjekur trajnimin e mbajtur nga SIGMA për harmonizimin e ligjit të prokurimit publik me direktivat e BE-së.

30. Gjatë vitit 2019, OSHP përmes të autorizuares së saj zyrtares ligjore ka marrë pjesë në punëtorinë: „Komunikimi për MSA-në në Kosovë – ndërmjet shërbimit të rregullt për media dhe edukimit publik të rëndësisë strategjike".

31. Vlen të potencohet fakti se OSHP ka nevojë për trajnim të stafit në fusha të ndryshme që ndërlidhen me prokurimin publik, e që mund të thuhet se gjatë 2019-tës këto trajnime kanë qenë të pakta për shkak të buxhetit të limituar, e që për këtë edhe është paraparë nevoja për rritjen e buxhetit të dedikuar për vitin fiskal.

V. Puna gjatë vitit 2019

32. Paneli shqyrtues gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar **981** ankesa gjithesej. Paneli shqyrtues ka aprovuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese, si të bazuara në **261** raste, duke konstatuar se pretendimet e palëve ankimore nuk kanë qenë të mbështetura në argumente ligjore që të aprovohen ankesat e tyre; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave në **535** raste, duke konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar i ofertave nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkeljet e caktuara të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik; Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ri-tenderim) në **47** raste, nisur nga shkeljet e konstatuara të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit, vlerësim jo të drejtë të ofertave apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit; **43** ankesa janë hedhur poshtë për shkak të mos-kompletimit të tyre brenda afatit ligjor në pajtim me nenet 111.4 dhe 118.1 të LPP-së; Para se të merren në shqyrtim nga Paneli Shqyrtues, **30** ankesa të dorëzuara, janë tërhequr nga operatorët ekonomik ankues; Paneli shqyrtues gjatë vitit 2019, ka lëshuar gjithsejtë **20** urdhëresa, Shtyrje e afatit për ofertim **8** raste, Gjobë **2** raste; dhe Ndryshim në dosje të tenderit **37** raste.

33. Në formë grafike janë të paraqitura numri dhe përqindja e ankesave të pranuara dhe të shqyrtuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2019.



34. Operatorët Ekonomik me rastin e paraqitjeve të ankesave konform nenit 118 të LPP-së, dhe Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave konform nenit 14 kanë qenë të obliguar të deponojnë sigurimin e ankesave një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

Nr	Autoriteti Kontarktues	Ankesa të pranuara	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim-Zgajtje e afatiti për ofertim
1	Zyra e Kryeministrit	1	1							
2	Kuvendi i RKS	10	1	6	3					
3	Ministria e Shëndetësisë	19	9	8		2				
4	Ministria e Mbrojtjes	15	2	11			1	1		
5	MBPZHR	3	1	1			1			
6	MKRS	17	1	15					1	
7	Ministria e	75	29	36	1	2	6			1

	Infrastrukturës									
8	Ministria e Punëve të Brendëshme	9	4	3			1	1		
9	Minsitria e Administratës Publike	7	2	5						
10	Ministria e Arsimit	17	7	7	1	1	1			
11	Ministria e Financave	1		1						
12	MPMS	1		1						
13	MZHE	4	3	1						
14	MZHR	1		1						
15	MMPH	20	6	10	2	2				
16	Ministria e Integrimeve Europiane	1	1							
17	Ministria e Punëve të Jashtme	1		1						
18	Ministria e Drejtësisë	2	1				1			
19	Policia e Kosovës	32	9	13	2	1	2	3	2	
20	KEK	70	22	40	4	1	2			1
21	AQP	24	3	18		1		2		
22	QKUK	17	4	8	1	1	1	1	1	
23	SHSKUK	21	7	7	1			1	5	
24	Univ Hasan Prishtina	24	1	12	2	2	1		5	1
Nr	Autoriteti Kontarktues	Ankesa të pranuara	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim-Zgajtje e afatiti për ofertim
25	KK Prishtinë	58	12	37	1	2	3	1	2	
26	KK Prizren	42	11	23	4		3		1	
27	KK Mitrovicë	15	9		2		1	1	2	
28	KK Gjakovë	27	6	14	3		1	1	2	
29	KK Drenas	7		7						
30	KK Lipjan	16	3	10		2			1	
31	KK Novobërdë	2	1	1						

32	KK Kaçanik	13	5	5	1		1			1
33	KK Shtime	1		1						
34	KK Viti	4		4						
35	KK Dragash	4		4						
36	KK Graçanicë	2	1						1	
37	KK Ferizaj	12	3	8			1			
38	KK Obiliq	9	1	4	2		2			
39	KK Deçan	7	3	2				1		1
40	KK Klinë	27	3	23		1				
41	KK Fushë Kosovë	7	3	2	1		1			
42	KK Vushtrri	11	4	6					1	
43	KK Kamenicë	4	1	3						
44	KK Skënderaj	2	1		1					
45	KK Podujevë	9	6	3						
46	KK Malishevë	17	1	14	1		1			
47	KK Gjilan	21	3	6		5	2	1	3	1
48	KK Shtërpcë	1	1							
49	KK Istog	15	5	7		2	1			
50	KK Suharekë	22	6	13		2		1		
51	KK Junik	5		5						
52	KK Pejë	7	6	1						
53	KK Rahovec	18	3	10	3			2		
54	KK Mamushë	2		1				1		
55	KK Ranillug	1			1					
56	KK Zveçan	2		2						

Nr	Autoriteti Kontarktues	Ankesa të pranu	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të	Ndryshim në Dosje të	Përmirësim-Zgjajtje

		ara						vend. PSH-së	Tenderit	e afatiti për ofertim
57	NPB	3		2		1				
58	Dogana e Kosovës	3		3						
59	Stacioni I Autobusëve	3		2					1	
60	Avokati i Popullit	2	1	1						
61	Posta e Kosovës	2		1	1					
62	KRM Pastrimi	7		6			1			
63	AKP	2	1	1						
64	Trepça	8	4	4						
65	Prokuroria e Shtetit	6		4			1		1	
66	AKSP	6	3						3	
67	RTK	2		2						
68	Shërbimi Korrektues I Kosovës	10	1	9						
69	Gjykata Kushtetuese	1		1						
70	Këshilli Gjyqësor I Kosovës	10	1	7	1		1			
71	SKQZ	1			1					
72	KQZ	1	1							
73	ATK	5	3	2						
74	ASHNA	6	3	3						
75	Agjencia e Menagjimit Emergjent	6	1	3	1			1		
76	KMDK	2		2						
77	KPMM	3		2			1			
78	KOSTT sh.a.	6	3	2	1					
79	AKKVP	3	1	1					1	
80	Agjencia Kadastale e Kosovës	2	2							
81	Zyra Kombëtare e Auditimit	5		4			1			
82	Univ.Kadri Zeka	8	2	5	1					

Nr	Autoriteti	Ankes	Aprov. i	Ri	Ri	Tërheqj	Flakje e	Urdhër	Ndryshi	Përmirë

	Kontarktues	a të pranu ara	vend. të AK-së	vlerësim	tenderi m	e e Anke.	Ankesës	për Zbatim të vend. PSH-së	m në Dosje të Tenderit	sim-Zgajtje e afatiti për ofertim
83	Spitali Regjional Prizren	3	1	1					1	
84	KRU Hidroregjion i Jugor Prizren	4	1	3						
85	Univ. Haxhi Zeka-Pejë	6	1	4	1					
86	KRU Hidromorava	3	1	2						
87	Spitali Gjilan	1				1				
88	Universiteti I Mitrovicës	6	1	4	1					
89	KUR Prishtina	5	1	2		1	1			
90	Spitali Mitrovicë	1								1
91	Universiteti Ukshin Hoti Prizren	5	2	2					1	
92	Agjencia Veterines dhe Ushqimit	1	1							
93	AMKMK	2		2						
94	KRU Hidrodrini	2		1				1		
95	KRU Bifurkacioni	1					1			
96	Qendra e Studenteve	9	3	6						
97	Biblioteka Kombetare	2	1	1						
98	NPL Pallati I Rinisë	1	1							
99	Spitali Shtime	2	1	1						
100	KRM Ambienti	3	1	2						
101	Trafiku Urban	6	2	3			1			
102	CDI	2		2						
103	AKPPM	1		1						
104	Infrakos sh.a.	1					1			
10	KUR	1		1						

5	Mitrovica									

Nr	Autoriteti Kontarktues	Ankesa të pranuara	Aprov. i vend. të AK-së	Ri vlerësim	Ri tenderim	Tërheqje e Anke.	Flakje e Ankesës	Urdhër për Zbatim të vend. PSH-së	Ndryshim në Dosje të Tenderit	Përmirësim-Zgjatje e afatiti për ofertim
106	IMPK	2			1				1	
107	Spitali Pejë	3		3						
108	ASHAK	1								1
109	Termokos sh.a.	1		1						
110	IPK	1							1	
111	KRM Uniteti sh.a.	1	1							
112	Agjencioni Pyjor i Kosovës	2	1	1						
113	IKSHP	1		1						
114	Spitali Gjakovë	4		3	1					
115	Spitali Vushtrri	2	2							
------	**Gjithsejtë:**	981	261	535	47	30	43	20	37	8

GJOBAT DHE ANKESAT

35. Gjatë vitit 2019, OSHP-ja ka shqiptuar dy gjoba për mosrespektim të vendimeve të paneleve shqyrtuese dhe atë një ndaj AK-MSH në vlerë prej 10,000.00 € dhe një ndaj AK-KK Prishtinë në vlerë prej 5,000.00 €.

Tabela e gjobave-2019

Autoriteti kontraktues	Vendimi i PSH-së	Data e vendimit	Shuma e gjobës
Ministria e Shëndetësisë	136/19	23.05.2019	10,000.00 €
KK Prishtinë	274/19	29.07.2019	5,000.00 €
		Gjithsejtë	15,000.00 €

36. Gjatë vitit 2019, OSHP përmes përmbaruesit privat ka ekzekutuar dy gjoba të shqiptuara ndaj autoriteteve kontraktuese, gjatë viteve paraprake, dhe atë një ndaj Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës sipas vendimit Psh. nr 134, 137, 138/16 - 25,000.00 € dhe një ndaj KK Dragash sipas vendimit Psh. nr. 50/17- 5,000.00 €.

I. Ndarja e ankesave sipas muajve kalendarik

37. Gjatë vitit 2019, numri i ankesave sipas muajve kalendarik, ka pasuar ndryshime në disa muaj. Volumi më i madh i ankesave i përket muajve Korrik, Tetor dhe Dhjetor. Në formë statistikore, në tabelën e më poshtme janë paraqitur numri i ankesave të pranuara sipas muajve gjatë vitit 2019.



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Muajt	48	40	47	60	75	85	111	88	90	125	90	122

Klasifikimi i ankesave në bazë të vlerave – 2019

II. Urdhëresat e Shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese

38. Me LPP, përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit, pas shqyrtimit të ankesave, janë përfundimtare, mirëpo disa Autoritete Kontraktuese i kanë neglizhuar procedurat e prokurimit publik, duke mos i respektuar vendimet e paneleve shqyrtuese për rivlerësimin e ofertave apo anulimin e aktiviteteve të prokurimit. Veprimet e këtilla të Autoriteteve Kontraktuese përbëjnë shkelje të LPP-së, e njëkohësisht kanë edhe efekt negativ në shfrytëzimin racional të fondeve publike.

39. Për shkak të mos respektimit të vendimeve të mëparshme të Paneleve Shqyrtuese, OSHP-ja, ka shqiptuar gjithsej **20** urdhëresa ndaj Autoriteteve të ndryshme kontraktuese.

40. Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat lidhur me shqiptimin e urdhëresave ndaj Autoriteteve Kontraktuese, për mosrespektim të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese.

III. Diskualifikimi i Operatorëve Ekonomikë

41. OSHP-ja është kompetente për diskualifikim të operatorëve ekonomik konform nenit 99.2 të LPP-së. Në vijim është tabela me të dhënat, kërkesat e autoriteteve kontraktues dhe vendimet e OSHP-së në lidhje me këto kërkesa.

Tabela e kërkesave për diskualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe vendimet e OSHP

Nr.	AK	Operatori Ekonomik	Tirulli i Aktivitetit	Vendimi i OSHP-se
1	Trainkos Me nr prot 125/19 Dt.03.01.2019	" Nazeri 2000"	Sherbime te sigurimit fizik te objekteve te Trainkosit sha	Refuzohet kerkesa e AK-se per diskualifikim
2	KK Kaqanik Me nr. prot.163/19 dt13.02.2019	"NTG Blendi"	Furnizim me llap top dhe projektor	Refuzohet kërkesa e AK_se
3	KK Prishtine Me nr. prot.178/19 dt.19.02.2019	"NSH Viva Print-Gjilan"	Sinjalizimi horizontal dhe vertikali rrugeve -faza II-te 2018	Aprovohet si e bazuar kerkesa e AK-se,
4	KEK ME nr. prot.496/19 dt.14.05.2019	""NTP Bashkimi	Ndertimi I rrethojes se re ne TC Kosova B	Refuzohet kërkesa e AK_se
5	MI Me nr prot 548/19 dt 22.05.2019	"SAllahu shpk"	Strukturat ne zgjerimin e rruges Nacionale N9.1,segmenti Dollca- Gjakove L-31km , l-	Aprovohet si e bazuar kerkesa e AK-se,
6	MI Me nr. prot.646/19 dt.20.06.2019	"RSM Company	Rehabilitimi I rruges Rajonale Zhur Dragash -Brod	Aprovohet si e bazuar kerkesa e AK-se,
7	SHSKUK SP "Isa Grezda" Gjakove me nr.706/19 dt.08.07.2019	" Kosova Med healthcare shpk"	Furnizim me paisje mjekesore lot 1,furnizim me rentgen digjital	Refuzohet kërkesa e AK_se
8	MI	" Bujar Shabani B.I shpk	Renovimi I rruges	Refuzohet kërkesa

	Me nr. prot.792/19 dt.22.07.2019	NPSH Bageri”	Llapi ne Obiliq R-120, L=3.000m	e AK-se
9	KK Prizren Me nr. prot.897/19 dt.25.07.2019	“ Grami shpk // Pastror Kosova shp”	Furnizim me nje automjet special me paisje per sherbimin e zjarrefikesve ne KK Prizren	Refuzohet kërkesa e AK-se
10	MF me nr. prot.904/19 dt.26.07.2019	Europrinty shpk “”	Furnizim me material hargjues per TI 2019 NJIF	Refuzohet kërkesa e AK-se,
11	MPB ME nr. prot.914/19 Dt.30.07.2019	“L-group”	Riparimet ne objektin e QPD -QRA ne Rahovec	Refuzohet kërkesa e AK-se

Nr.	AK	Operatori Ekonomik	Tirulli i Aktivitetit	Vendimi i OSHP-se
12	MPB Me nr. prot.915/19 30.07.2019	“ Global Consulting & development Associates”	L-1---Sherbime te perkthimeve me shkrim dhe me goje ,gjuhet evropiane L-2--Sherbime te perkthimeve me goje dhe shkrim gjyhet yjera jashte evropiane	Refuzohet kërkesa e AK-se
13	MASHT Me nr prot 980/19 Dt.14.08.2019	“SHpk Avduli”	Ndertimi i shkolles se mesme te ulet ne talinoc i muhaxhereve	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se
14	AQP Me nr. prot 1045/19 dt.09.09.2019	“ Konz.AlfaGroup shpk&Fadi Com SHpk”	Servisimi dhe rregullimi i lopates se ngarkuesit CAT 966 F	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se
15	MI Me nr. prot.1148/19 dt25.09.2019	“Lirigzoni shpk”	Rekonstruimi I rruges regjionale R115, pjesa Prizren- Prevall km 0.==, km 16	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se
16	MI ME nr. prot.1149/19 dt25.09.2019	“Arfa Group shpk “	Furnizim me beton, Furnizim me asphalt //Sanimi i Rreshqitzes ne rrugen Hani I Elezit	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se
17	MI 1150/19 dt 25.09.2019	“Ledi Ing”	Sanimi i Rreshqitzes ne rrugen Hani i Elezit	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se
18	Policia e Kosoves Me nr. prot.	“Artius grup shpk	Furnizim me paisje policore	Aprovim i kerkeses se AK-

	1188/19 dt.27.09.2019			se AK-se	
19	SKQZ me nr.1190/19 dt.29.10.2019	"Offie printy"	Shtypja e materialeve zgjedhore per zgjedhjet e parakohshme per Kuvendin e Kosoves 2019,L-1.2.3.4.5	Aprovim i kerkeses se AK-se AK-se	
20	AQP Me nr. prot.1284/19 dt25.10..201	"PM Group"	Furnizim me material higjienik per nevojat e fondit te kursimeve pensionale te kosoves	Refuzohet kërkesa e AK-se	
21	KK SUhareke Me nr. prot.1355/19 dt.13.11.2019	" Xoni shpk NSH Osmani"	Sherbimet e zhvendosjes me merimenge dhe bllokimi I automjeteve ne teritorin e Komunes se Suharekes	Refuzohet kërkesa e AK-se	
22	KEK 1406/19 dt.03.12.2019	"Grami shpk"	Furnizim me paisje personale mbrojtese ne pune,Furnizim me paisje personale dhe	Refuzohet kërkesa e AK-se	
23	KMDK 1412/19 Dt.05.12.2019	"Grami shpk "	Furnizim me nje kamion per transportimin e mbeturinave	Refuzohet kërkesa e AK-se	
24	KK Vushtrri 1474/19 dt.27.12.2019	" NNP Elektro"	Furnizim me nje kamion per transportimin e mbeturinave	Refuzohet kërkesa e AK-se	

IV. Të Dhënat nga Gjykatat

42. Gjatë vitit 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte gjithsej shtatëdhjetë e tetë (78) përfaqësime pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.

43. Për më tepër, gjatë vitit 2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit është përgjigjur në padi, gjithsej, tridhjetë e shtatë (37) here konform aktvendime për përgjigje në padi të dorëzuara nga gjykatat kompetente.

44. Gjatë vitit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar në dyzet e dy (42) raste kërkesëpaditë e paditëseve të parashtruara kundër vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ndërkaq ka aprovuar paditë në katërmbëdhjetë (14) raste.

45. Paditësit/operatorët ekonomikë, kanë parashtruar pesëmbëdhjetë (15) ankesa në Gjykatën e Apelit kundër vendimeve të Gjykatës Themelore. Në tetë (8) rastë ankesat janë refuzuar si të pabazuara nga Gjykata e Apelit. Në një (1) rast, Gjykata e Apelit e ka aprovuar ankesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit si të bazuar, ndërsa në një (1) rast tjetër e ka refuzuar ankesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit si të pabazuar.

46. Lidhur me propozimet e paditësve/operatorëve ekonomikë për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, gjykatat në shtatë (7) raste kanë refuzuar propozimet parashtruesve të propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ndërsa në një (1) rast e ka aprovuar propozimin.

47. Gjykatat në dy (2) raste kanë refuzuar propozim për caktimin e nxjerrjes së provës me ekspertizë. Gjykatat në 3 (tre) raste kanë pezulluar procedurën për shqyrtim të padisë.

48. Gjykata Supreme gjatë vitit 2019, ka nxjerrë një (1) Aktgjykim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të evidentuar me numër të lëndës ARJ- UZVP. Nr. 46/19.

TË GJETURAT E ZYRËS SË PËRGJITHSHME TË AUDITORIT

49. Zyra e Auditorit të Përgjithëshem ka rekomanduar që gjatë vitit 2019 të ndërmerren veprimet si në vijim:

49.1 Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha vendimet e OSHP-së bëhen publike në ueb faqe brenda afatit ligjor prej pesë (5) ditëve.

49.2 Kryetari i OSHP-së duhet të sigurohet që në përputhje me kërkesa e LPP dhe rregullores së punës të OSHP-së të nxjerr një afat apo kohë të

arsyeshme brenda së cilët duhet t'u kthen mjetet operatorëve ekonomik që kanë bërë kërkesë për kthim të mjeteve.

49.3 Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë që përzgjedhja e ekspertëve profesional të prokurimit bëhet sipas kritereve të kërkuara në shpallje të konkursit dhe shqyrtimi i lëndëve bëhet vetëm nga ata që kanë çertifikata të vlefshme/valide.

49.4 Kryetari i OSHP-së duhet të forcoj nivelin e kontrollit mbi menaxhimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve, duke mos lejuar kryerjen e asnjë pagesë pa dokumentacion të plotë për blerje/shërbim.

49.5 Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që autorizimi i ekspertëve profesional shqyrtues të bëhet në bazë të rregullores së punës të OSHP-së në mënyrë që ekspertizat të kryhen vetëm nga ekspertet kompetent.

50. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithëshem janë përmbushur gjatë vitit 2019.

SHTOJCA I - RAPORTI FINANCIAR 2019